

STATUTI

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

« KoteKo» SH.P.K.

(I NDRYSHUAR)



Sot në datë 03.02.2012 ,në respektim të nenit 230 të ligjit 9901 datë 14-04-2008 "Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare" me qëllim të ortakut të vetëm të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar «KoteKo» sh.p.k. hartohet statuti i ndryshuar dhe nënshkruhet nga ortaku i vetëm :

Neni 1

Thanas Kote, i biri i Thomait, lindur më 19 Tetor 1950 dhe banues në Korçë, Rr. "Dhori Lako" Nr. 27, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me numër të kartës së identitetit 028896895 vendos të krijojë një shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar. Shoqëria e fiton personalitetin juridik nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar pranë QKR-se dhe do të zhvillojë aktivitetin e saj në bazë të legjislacionit në fuqi.

Shoqëria Tregtare me përgjegjësi të kufizuar "KoteKo", e cila me poshtë do të emërtohet vetëm "Shoqëria" është Shoqëri Tregtare e themeluar në bazë të Aktit të Themelimit nga ortaku i vetëm Thanas Kote, me poshtë i quajtur "Ortaku i Vetëm".

Ortaku i vetëm bie dakord që, përveç sa është parashikuar në Aktin e Themelimit, rregullat dhe marrëdhëniet e veprimtarisë së Shoqërisë do të rregullohen nga ky Statut.

Neni 2

Emërtimi dhe Vula e Shoqërisë

Shoqëria ka emërtimin e saj "KoteKo" Sh.P.K..

Shoqëria ka vulën e saj, në të cilën do të jenë të shkruara emri dhe selia e Shoqërisë.

Neni 3

Selia, ekskluziviteti dhe filialet e Shoqërisë

Shoqëria ka selinë e saj në Korçë, Rr. Konferenca e Labinotit Nr. 32 (Ish Kampi i Punëtorëve Korçë) me numër telefoni 08224 89 92. Ne vartësi nga zbatimi dhe zgjerimi i aktivitetit të saj, Shoqëria ka të drejte të ndryshoje edhe selinë e saj.

Ndryshimi i selisë nuk sjell modifikime në Statut dhe kryhet me vendim të Asamblesë së Ortakevc.

Shoqëria ka të regjistruar ekskluzivitetin në emrin e saj "KoteKo" Sh.P.K.

Gjithashtu Shoqëria ka të drejte të hapë filiale, dege, përfaqësi dhe zyra si në territorin e Republikës së Shqipërisë ashtu edhe jashtë tij, me vendim të arsyetuar të Ortakut të Vetëm.

Neni 4

Pjesëmarrja në Shoqëri

Shoqëria është e hapet për ortake vendas dhe të huaj, me kusht që të pranojë Aktin e Themelimit dhe këtë Statut të Shoqërisë, si dhe për bashkëpunim dhe lidhje kontratash me të gjitha firmat e biznesit që veprojnë në Shqipëri dhe jashtë saj.

Neni 5

Kohëzgjatja e Shoqërisë

Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë është mbi 10 vjet. Kjo veprimtari fillon me regjistrimin e shoqërisë në QKR dhe me marrjen e lejes së ushtrimit të veprimtarisë së saj në organet tatimore.

Neni 6

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë

Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj :



Prodhim e tregtim te materialeve te ndërtimit te llojeve te ndryshme, ndërtim te objekteve gjithfarësh, rrugësh, ujësjellës, hidroteknike, tarracime terrenesh, ndërtime vepra arti, kanalizime, kulla, rikonstruksione te godinave, mirëmbajtje dhe zhvillim dekori, projektme ne fushën e ndërtimit.

Tregtim me shumice e pakice te mallrave industriale, lendeve te para e materialeve te ndërtimit si dhe makineri ndërtimi e pjese këmbimi për to, duhan, cigare e tjalla ushqimore, fruta e perime, konfeksione e tekstile te çdo lloji, mjete transporti e pjese këmbimi për to, shërbime spedicioni, shërbime te ndryshme, tregtim karburanti e nënproduktet e naftës, veprimtari import-eksport qe lidhen me objektin e veprimtarisë se shoqërisë, tregtim te këpucëve, pajisjeve elektroshtëpiake, elektrike, elektronike si dhe pjese këmbimi për to, pajisje mobilim zyresh, pajisje kancelarie, pajisje hidrosaniatre e termosaniatre, materiale e makineri për industrinë e lehte dhe ushqimore, veprimtari import-eksport qe lidhen me objektin e veprimtarisë se shoqërisë, transport te brendshëm dhe te jashtëm, te mallrave dhe te njerëzve për vete dhe për të tretë ne mënyrë tokësore.

Neni 7


Kapitali themeltar i Shoqërisë

Kapitali themeltar i Shoqërisë ne çastin e themelimit te saj është 31,353,501 (tridhjetë e nje milion e treqind e pesedhjetë e tre mije e peseqind e nje) lekë. Kjo shumë është derdhur ne masën 100% nga Ortaku i Vetëm i Shoqërisë, z. Thanas Kote.

Z. Thanas Kote zotëron 100 kuotat e Kapitalit Themeltar të Shoqërisë. Vlera e kuotave është 313,535.1 lekë për çdo kuotë. Kuotat rriten ne vlere me rritjen e kapitalit Themeltar te Shoqërisë.

Kapitali Themeltar i Shoqërisë do te rritet nëpërmjet nënshkrimit dhe derdhjes se kontributeve ne te holla ose me anë te përfshirjes në të, të vlerës se objekteve apo pasurive te luajtshme e te paluajtshme te fituara ose qe do te fitohen ne mënyrë te ndryshme dhe te ligjshme nga Shoqëria. Vlerësimi i tyre do te behet ne përputhje me dispozitat e ligjit " Për Shoqëritë Tregtare".

Ne Librin e Llogarive te Shoqërisë regjistrohet Kapitali Themeltar dhe detajohet kontributi i derdhur nga Ortaku i Vetëm ose nga ortakët e tjerë qe mund te shtohen.



Kapitali Themeltar mund te tërhiqet nga banka vetëm me dokument shkresor noterial te Ortakut te Vetëm ose te Asamblesë se Ortakeve. (po te shtohen ortakët ne te ardhmen).

Neni 8

Veprimtaria e Shoqërisë

Shoqëria e zhvillon veprimtarinë e saj ne baze te parimeve ekonomike dhe rezultatet pasqyrohen ne bilancet e saj. Veprimet e Shoqërisë pasqyrohen ne kontabilitet duke zbatuar parimet baze te kontabilitetit te parashikuara nga legjislacioni shqiptar.

Neni 9

Disponimi i pasurisë

Shoqëria krijon një fond- pasuri të saj dhe është pronare e pasurive te saj.

Neni 10

Ndarja e fitimeve

Viti financiar i shoqërisë fillon me date 1 Janar dhe përfundon ne datën 31 Dhjetor te çdo viti. Nga ky rregull bën përjashtim viti i parë i veprimtarisë se Shoqërisë ku viti financiar fillon me regjistrimin e Shoqërisë ne organet tatimore dhe te taksave te Bashkisë se Tiranës.

Neni 11

Llogaria e Shoqërisë

Shoqëria ka llogarinë e saj rrjedhëse ne banke ne lekë dhe ne dollarë. Nëpërmjet llogarisë bankare shoqëria kryen te gjitha transaksionet financiare për shlyerjen e detyrimeve ndaj personave te tretë, shitet dhe klientëve te saj, por kjo nuk e përjashton kryerjen e veprimeve me para ne dore për blerje e shërbime, duke e bërë pagesën ne monedhe shqiptare, lekun. Te gjitha llogarite e Shoqërisë mbahen ne lekë.

Neni 12

Organet drejtuese te Shoqërisë dhe kompetencat e tyre



Organet drejtuese te Shoqërisë janë :

1. Vendimet e Ortakut te Vetëm.
2. Administratori.
3. Ekspertet kontabël e revizore.



Asambleja

Neni 13

Detyrat e organeve drejtuese te Shoqërisë

Asambleja është organi vendimor me i larte i shoqërisë, ose vendimet e Ortakut te Vetëm te Shoqërisë.

Asambleja miraton bilancin e Shoqërisë dhe ndarjen e fitimit. Emëron administratorët kur janë jashtë ortakërie, ekspertët e ndryshëm dhe financiarin e shoqërisë, përcakton numrin e punonjësve si dhe pagat, miraton rregulloren e brendshme të shoqërisë. Në çdo mbledhje të asamblesë ose të Ortakut te Vetëm është e domosdoshme te mbahen procesverbale duke e firmosur ne fund nga ortaku dhe çdo faqe procesverbali te jete e vulosur.

Te zhvillojnë tratativa, negoeiata, bisedime në emër dhe për llogari te Shoqërisë me palë te treta dhe te lidhin marrëveshje e kontrata në emër te saj me partnere te huaj dhe vendas dhe te ndjekin realizimin e detyrimeve te ndërsjella qe lidhen me veprimtarinë e Shoqërisë.

Te bëjnë porosi sipas te gjitha rregullave dhe praktikave tregtare te njohura dhe te përgjigjen për realizimin e tyre.

Te përcaktojë rrugët e realizimit te detyrimeve te saj, te përcaktojnë drejtimet ku duhet te përqendrohen investimet , te ndryshojnë fushën e veprimtarisë se Shoqërisë ose ta mbyllin veprimtarinë e saj kur ajo nuk është rentabël (me fitim).

Neni 14

Drejtimi Administrativ

Adminsitratori i pergjithshem i shoqerise " **KoteKo**" sh.p.k, eshte **Z.Thanas Kote.** (afati i administratorit maksimumi 5 vjecar)

Neni 15

Administratori ka për detyrë organizimin dhe drejtimin e shoqërisë. Ai mund të kryejë të gjitha veprimet e administrimit në interes të shoqërisë.

Neni 16

Administratori i përgjithshëm dhe personat që përfaqësojnë shoqërinë në bazë të prokurës janë të detyruar të mbrojnë dhe të ruajnë sekretet profesionale, njohuritë, përyojën e fituar në këtë shoqëri, të marrin të gjitha masat për mos këtë rrjedhje pjesore apo të plote të sekretit të shoqërisë.

Neni 17

Në marrëdhënie me të tretet administratori angazhon shoqërinë nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj të veprimtarisë.

Neni 18

Organi më i lartë Drejtues dhe Vendimor i shoqërisë me ortak të vetëm është Administratori i saj i cili në pozitën e asamblese vendimet e mara prej tij evidentohen në regjistrin e shoqërisë.

Neni 19

Administrimi i shoqërisë kryhet nga Administratori.

Administratorit i jepen të gjitha kompetencat e administrimit të zakonshëm të shoqërisë, e drejta e përfaqësimit ligjor të saj me të trete dhe e gjykimit me aktet e administrimit të zakonshëm, si të lidhe kontrata pune me të trete, të kryejë veprime me bankën brenda limiteve, përfaqësimin e shoqërisë në gjykate, të emerojë avokate, etj.

Neni 20

Për administrimin e të ardhurave të shoqërisë gjatë aktivitetit të saj do të caktohen specialiste kontabel për kryerjen e të gjitha veprimeve financiare, për evidentimin e të ardhurave të realizuara, fitimit si dhe detyrimeve. Ato do të evidentohen në librat e llogarive. Ekspertet kontabel emerohen me vendim të Administratorit.

Neni 21

Vlera ligjore e dokumenteve

Të gjitha dokumente kontabël të shoqërisë, dokumente ekonomike dhe financiare, faturat e tjera kanë vlerë ligjore vetëm kur janë të nënshkruara nga Administratori dhe kanë vulën e Shoqërisë. Të drejtën e nënshkrimit të dokumenteve si firme e ka Administratori.



Neni 22

Bilancet dhe kontroll-revizionimi

Veprimtaria ekonomike dhe financiare e shoqërisë fillon me 1 Janar dhe mbyllet ne 31 Dhjetor te atij viti. Ne fund te çdo tremujori behet bilanci periodik, kurse ne fund te vitit bilanci vjetor.

Neni 23

Pranimi i ortakeve te rinj

Pranimi i ortakeve te rinj behet me vendim te Ortakut te Vetëm te Shoqërisë. Ortaket e rinj duhet te bëjnë kërkesë me shkrim dhe te pranojnë Aktin Themeltar dhe Statutin e Shoqërisë. Ortaku quhet i pranuar kur bëhet regjistrimi i tij ne Gjykatën e rrethit Gjyqesor Korçe dhe ne Zyrën e tatim taksave.

Neni 24

Te drejtat e ortakeve te rinj ne Shoqëri

Ortaket kanë të drejte te njihen me te gjithë veprimtarinë e Shoqërisë ne fushën ekonomike e financiare dhe me te gjithë dokumentacionin përkatës qe nga dita e krijimit te Shoqërisë. Ata janë te detyruar te marrin pjese aktive ne te gjithë veprimtarinë e Shoqërisë.

Neni 25


Te punësuarit ne Shoqëri

Për te plotësuar shërbimet e saj ndaj klientëve ose shoqërive me te cilat ka kontaktuar, Shoqëria merr dhe punëson punonjës te sferës se ndërtimit, te tregtisë, shërbimeve dhe specialiteteve të tjera të nevojshme.

Neni 26

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Kur gjate veprimtarisë praktike te Shoqërisë lindin mosmarrëveshje ndërmjet ortakeve (ne r rastin kur shoqëria mund te shtohet me ortake te rinj), ato zgjidhen ne mirëkuptim konsensus ne mes ortakeve, dhe kur kjo nuk arrihet, çdo



ortak ka te drejtën t'i drejtohet për zgjidhje Gjykatës te rrethit Gjyqesor Korce me kërkesë padie te rregullt.

Neni 27

Probleme te tjera

Për problemet që nuk janë pasqyruar ne këtë Statut dhe kur për to linden mosmarrëveshje dhe palët nuk i zgjidhin dot me mirëkuptim, ato kane te drejte t'i referohen Ligjit Nr. 7638 date 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare", kurse për çështjet e zakonshme, Kodit te Ri Civil te Shqipërisë.

Neni 28

Shpërndarja e Shoqërisë

Shoqëria merr fund kur:

- Me vendim te arsyetuar te Ortakut te saj te Vetëm ose Administratoreve te saj (ne rastin kur Shoqëria është shtuar me ortake te rinj) vendoset shpërndarja e Shoqërisë, riorganizimi i saj ose pushimi i veprimtarisë se saj.
- Është plotësuar afati 10 vjeçar i aktivitetit te saj, i përcaktuar ne Aktin Themeltar dhe Ortaku i Vetëm ose ortakët nuk dëshirojnë te vazhdohet më tej veprimtaria e saj.
- Shoqëria shpall falimentimin dhe ky falimentim është në përputhje me kërkesat e ligjit "Për falimentimet".
- Gjate një periudhe kohe të vlerësuar nga ortakët Shoqëria rezulton me humbje te pajustificuara dhe nuk justifikon me tej ekzistencën e saj.
- Vdes Ortaku Themelues i Shoqërisë dhe nuk ka dëshiruar më parë me kërkesë me shkrim t'ia lerë trashëgimtarëve te tij Shoqërinë, ose vdes një nga ortakët dhe ortakët e tjerë nuk dëshirojnë vazhdimin e mëtejshëm të Shoqërisë.


Neni 29

Ky statut i Shoqërisë Tregtare me Përgjegjësi te Kufizuar "KoteKo" Sh.P.K. u redaktua ne katër kopje identike, me vlerë të njëjtë ligjore në gjuhën shqipe, me kërkesën e Ortakut të Vetëm Themelues të Shoqërisë dhe me vullnetin e tij të lirë e të plotë u nënshkrua prej tij përpara Noterit, i cili e vërtetoi dhe e regjistroi rregullisht ne Regjistrin Themeltar te Noterisë-Bilisht.

STATUTI "KoteKo" SH.P.K.

ORTAKU I VETËM

Thanas Kote



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE KORCE
ZYRA NOTERIALE BILISHT
NOTER JORGO GJAMO
Nr. 131 Rep. 131 Kol



VERTETIM
(Nenshkrimi)

Sot ne daten 03-02-2012.para meje Noter Jorgo Gjamo.anetar I dhomes se notereve Korce.me seli ne qytetin e Bilishtit. u paraqiten personalisht palet:

I-Thanas Kote i biri i Thomait, lindur me 19 Tetor 1950 dhe banues ne Korçë. Rr. "Dhori Lako" Nr. 27, madhor me zotësi te plote juridike dhe për te vepruar, me numër te kartës se identitetit 028896895.

I mesipermi madhor me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar identifikuar me ane te letrnjoflimit te tij te identifikimit.pasi me bindi se vepron me vullnet te lire dhe te plote deklaroi se neshkrimi I bere ne aktin Statut i Shoqerise me Pergjegjesi te Kulizuar "KoteKo"sh.p.k bashkelidhur. eshte I tij dhe se mer persiper cdo detyrim ligjor per shkak te ketij neshkrimi.

Une noteri mbasi verifikova identitetin e tij dhe e gjej deklarimin ne perputhje me ligjin e nenshkruaj kete akt duke I dhene fuqine ligjore.

NOTER
Jorgo Gj.GJAMO
[Signature]
2012

